Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN "FORCIMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS SHËRBIMIT TË PROVËS DHE PUSHTETIT VENDOR"

13 nëntor 2012

Ministër Halimi,
Ministër Noka,
Drejtor i Përgjithshëm Sefgjini,
Zonja dhe zotërinj,

Mirëdita!

Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, është kënaqësi për mua t'ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë, organizuar me Shërbimin shqiptar të Provës, të Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo veprimtari mbështetet në partneritetin tonë të fortë me Ministrinë e Drejtësisë dhe synon të trajtojë në mënyrë të përbashkët çështjet kryesore të reformës në drejtësi.

Prania e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Brendshëm është një tregues i rëndësisë së bashkëpunimit të Prezencës me autoritetet shqiptare në këtë proces, veçanërisht në kontekstin e 100-vjetorit të pavarësisë.

Mandati i Prezencës së OSBE-së përfshin mbështetjen për reformën në drejtësi si një element i rëndësishëm. Ajo qëndron, gjithashtu, në thelb të përpjekjeve të Shqipërisë për reforma dhe të rrugës së saj evropiane. Disa nga hapat e shumtë për reformë përbëjnë fusha krejtësisht të reja për Shqipërinë në momentin që ato janë ndërmarrë. Prova dhe shërbimi i provës janë ndër hapat më të spikatura novatore.

Forcimi i bashkëpunimit në sistemin e provës është ajo çka na ka mbledhur këtu sot. Qëllimi i shërbimit të provës është që të kontribuojë për një drejtësi më të mirë penale, si edhe për një siguri më të madhe të publikut duke parandaluar dhe ulur numrin e veprave penale dhe duke u dhënë ndërkohë mundësinë autorëve të veprave të kryera penale që të bëjnë kthesë e të kthehen shpejt në shoqëri si anëtare të dobishëm të saj. Do t'i kthehem shumë shpejt kësaj pike.

Instrumentet ndërkombëtare në të cilat është angazhuar Shqipëria të zbatojë, kanë rekomanduar një përdorim më të madh të dënimeve alternative me qëllim që të reduktohet problemi i mbipopullimit të burgjeve dhe të luftohet përjashtimi social bashkë me pasojat e përgjithshme negative të burgimit të panevojshëm.

Shërbimi shqiptar i Provës përfaqëson një hap të madh përpara në reformimin e sistemit të drejtësisë penale në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të OSBE-së.

Prezenca është përshirë aktivisht në mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë në ngritjen para tri vjetësh të Shërbimit të Provës, duke kontribuar në efikasitetin e tij, dhe duke asistuar përmes veprimtarive për rritjen e kapacitetit të punonjësve të këtij shërbimi dhe trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve vendorë. Kohë novatore, siç sapo theksova.

Ndonëse shërbimi i provës përbën një institucion relativisht të ri, ai ka arritur tashmë shumë brenda një kohe të shkurtër. Një pjesë e madhe e kësaj historie suksesi të deritanishëm duhet t'i atribuohet stafit profesional të Shërbimit të Provës, të cilin do të doja ta përgëzoja për përkushtimin e, sigurisht, edhe për punën e vështirë.

Zbatimi i dënimeve alternative kërkon bashkëpunimin e të gjithë sektorëve të drejtësisë. Kjo përfshin përfshirjen aktive të qeverive vendore dhe të shoqërisë civile, që është edhe tema e takimit të sotëm.

Bashkëpunimi mes organeve të ndryshme është vendimtar për suksesin e përpjekjeve të shërbimit të provës. Ai duhet të përbëjë një prioritet në nivel politikash.

Ky ka qenë objektivi i trajnimeve të ndryshme që Prezenca, së bashku me Shërbimin e Provës, ka organizuar në dy vitet e fundit, si për punonjësit socialë nga Tirana, Korça, Burreli dhe Gjirokastra, si edhe i disa tryezave të rrumbullakëta për OJF-të.

Jam i gëzuar që shoh këtu sot shumë kryetarë bashkie dhe përfaqësues të tjerë të njësive të qeverisë vendore. Ju, si përfaqësues të zgjedhur, keni përgjegjësi kyçe në këtë proces.

Në këtë aspekt, jam i kënaqur që mësoj se Shërbimi i Provës ka nënshkruar tashmë 228 Memorandume Mirëkuptimi me njësi të qeverisë vendore, që kanë për qëllim kryerjen e dënimeve alternative në nivel lokal, në mënyrë që personat e dënuar të jenë afër vendbanimeve të tyre.

Qëllimi është që të ndihmojë rehabilitimin e autorëve të veprave penale dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri, duke filluar me komunitetet në vendin ku ata banojnë. Shërbimi i provës është në të vërtetë një mundësi që u jepet autorëve të veprave penale për t'u ri-integruar në shoqëri dhe ka shumë kuptim që kjo të ndodhë në komunitetet lokale.

Përfshirja sociale autorëve të veprave penale përmes sanksioneve apo masave që duhen ndërmarrë në komunitet përbën një hap përpara në garantimin e sigurisë së komuniteteve. Përbën një hap përpara në parandalimin e krimit.

Meqë ministri i Brendshëm është i pranishëm, do të doja të theksoja rolin thelbësor qe ka policia, sidomos në nivelin vendor, në zbatimin e dënimeve alternative.

Mbikëqyrja nuk duhet parë thjesht si një masë kontrolli, por më tepër si një mënyrë këshillimi, asistimi dhe motivimi për autorët e veprave penale. Mbikëqyrja ka për qëllim të plotësojë nevojat e të dënuarve për një rikthim pa probleme në shoqëri, si punësimi, strehimi dhe arsimimi. Ajo duhet, gjithashtu, të sigurojë respektimin e kushteve të përcaktuara nga gjykata, të reduktojë risqet e përsëritjes së veprës penale dhe të ndihmojë individët që ata të bëhen qytetarë që i përmbahen ligjit.

Zonja dhe zotërinj,

Sigurisht që kërkohen aftësi, përvojë dhe përkushtim për gjetjen e ekuilibrit midis ndëshkimit e trajtimit dhe rehabilitimit e ri-integrimit të autorëve të veprave penale në shoqëri. Këto janë sfida reale, ku ndonjëherë hasim arsye të dukshme kontradiktore, apo më saktë, argumente të vlefshme për njërën zgjidhje apo tjetrën. Por jini të sigurt, të gjitha sistemet e drejtësisë penale që e meritojnë të quhen kështu, duke filluar nga sistemet e drejtësisë në demokraci, përballen

me këto pyetje dhe duhet të arrijnë zgjidhje të pranuara gjerësisht pas diskutimesh konstruktive.

Në thelb, bëhet fjalë si për të garantuar sigurinë e komunitetit në një shoqëri të mbështetur në të drejtat e njeriut, ashtu edhe për t'i dhënë një mundësi individit për rehabilitim. Përmes individit të rehabilituar, rritet edhe mundësia për forcimin e shoqërisë.

Një shërbim prove plotësisht funksional përbën edhe një kontribut të prekshëm për forcimin e shtetit të së drejtës, një objektiv thelbësor për progresin e këtij vendi.

Prezenca e OSBE-së do të vazhdojë ta mbështesë Ministrinë e Drejtësisë në punën e saj të mirë për vendin dhe, sidomos, në zbatimin e reformave të sektorit të drejtësisë penale.

Me lejoni t'ju uroj një konferencë shumë të suksesshme dhe frytdhënëse.

Faleminderit!

Fund